

V E N D I M
Nr.85, datë 18.2.1999

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR PROJEKTIN “FOND PËR STUDIME DHE SPECIALISTË”, ME NJË FOND GRANT PREJ 800 000 DM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të nenit 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit teknik ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin “Fond për studime dhe specialistë”, me një shumë falas prej 800 000 (tetëqind mijë) DM.
 2. Ngarkohen ministritë dhe institucionet qendrore, që përfitojnë nga marrëveshja, të përballojnë detyrimet fiskale dhe tatimore, që rrjedhin nga zbatimi i saj.
 3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për shkëmbimin e notave për hyrjen në fuqi të marrëveshjes.
 4. Ngarkohet Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë për koordinimin e këtij projekti.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko